



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇE

VENDIM

NR 22, Dt. 10.06.2024

PËR

RIMIRATIMIN E DHËNIES SË PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE, IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167, NR.2/539-ND,VOL.27,FAQE 168, TRUALLI NËN NDËRTESEN NR.2/708-N1, PJESE E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 TË CILAT JANË NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 77 gërma (e), me propozim të Kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë.

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr 2/539-Nd, Vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesen nr. 2/708-N1, pjesë e pasurisë nr.2/10,vol.33, faqe 19.
2. Të vijohet korrespondenca me institucionet e tjera përgjegjëse, procedura për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive objekt vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Specialisti i nivelit të lartë për shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat civile dhe Kabineti i Kryetarit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi

Miratuar me / 15 / Vota
Vota Pro / 15 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Astenim / 0 /
Zbardhur më datë /10/06/2024

Konceptori:Kësh. Juridik: M. Bylykbasni
Pranoi:Sek i K.Qarkut: B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇE

RELACION

“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE , IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167;NR.2/539-ND,VOL.27,FAQE 168; , TRUALLI NËN NDËRTESËN NR.2/708-N1, PJESË E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 TË CILAT JANË NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË”

Aktualisht Këshilli i Qarkut Korçë zotëron pasuritë, të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr 2/539-Nd, Vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën nr. 2/708-N1, pjesë e pasurisë nr.2/10,vol.33, faqe 19. të regjistruar në zbatim të VKM-së Nr. 601 datë 31.08.2016 “Për kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, dhe kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1223, datë 3.9.2008. të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë”.

Pas shkëmbimit të ndërtesave respektive midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë bazuar në VKM Nr. 601 datë 31.08.2016, për rregullimin e situatës së krijuar faktike dhe ligjore nga ky shkëmbim, Këshilli i Qarkut Korçë me mirëkuptim ka rishikuar mundësinë për tu siguruar ambiente për ushtrimin e funksioneve të tyre edhe institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucioneve të tjera.

Me kontratë huapërdorje Nr. 644 Prot. datë 17/07/2019 institucionit të Prefektit të Qarkut i është dhënë në përdorim kati i parë i godinës, pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m² ndodhur në Lgji.7, Rruga “28 Nëntori” nr.1, Korçë.

Kati përdhe i godinës, pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m² është vendosur në dispozicion të institucioneve të tjera të sistemuara, si Zyra e Përmbarimit Shtetëror Korçë, Zyra e Statistikës Korçë dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor.

Në kushtet aktuale vetë Këshilli i Qarkut ushtron veprimtarinë në ambientet e ndërtesës që është në pronësi të Bashkisë Korçë, me Kontratë Huapërdorje prej datës 01.09.2019 me një afat 10-vjeçar. Me qëllim sistemimin dhe mundësinë e ndërnyrjes për mirëmbajtje tek godina ku ushtron aktualisht aktivitetin, Këshilli i Qarkut Korçë i është drejtuar me një kërkesë Bashkisë Korçë për kalimin në pronësi të pasurive të identifikuar si pasuritë me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,5 m² , Nr.2/539-Nd, vol 27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m², në pronësi të Bashkisë Korçë.

Me VKB nr. 32 datë 29.02.2024 nga ana e Keshillit bashkiak Korçë është dhënë pëlqimi për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, pasuritë e identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349.6 m², Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m². Në këto kushte kërkohet nga Këshilli i Qarkut ridhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të tij, të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m², Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m².

Dhe me ridhënjen me VKB nr. 48 datë 28.03.2024 nga ana e Keshillit bashkiak Korçë është ridhënë pëlqimi për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, pasuritë e identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m², Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m².

Në këto kushte kërkohet nga Këshilli i Qarkut ridhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të tij, të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m², Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m².

Më datën 05.04.2024 me nr 323/1 është dhënë konfirmimi për bazueshmërinë ligjore nga Prefktura Korçë

Koncept:Kësh. Juridik: *M.Bylykbashi* 